

AKT THEMELIMI I SHOQËRISË ME PËRGJËGJËSI TË KUFIZUAR “Gildberd” shpk,

Në Tiranë, sot më datë 12.09.2024, ne te poshtëshënuarit;

Dijana Dulaj, i datëlindjes 18.01.1979, lindur ne Zllakuqan.Kosove dhe banues në Tiranë,identifikuar me dokument identifikimi,kartë identiteti te shtetit te Kosoves, me numër personal ID 1527185, dhe me dokument Leje Qendrimi te republikes se Shqiperise me numer identitetiH98118006M.

Gjovalin Mali i datëlindjes 19.07.1967, lindur Theth,Shkoder dhe banues ne Tirane,identifikuar me dokument identifikimi,kartë identiteti me numer personal G70719089W.

Me cilësinë e “ortakeve themelues”deklarojme se me vullnet të lirë të plotë, mbeshtetur në ligjin Nr.9901 datë 14.04.2008, “ Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar, ligjin Nr. 9723, datë 3.5.2007 “ Për Regjistrimin e Biznesit“, i ndryshuar, krijoj shoqërinë tregtare me përgjegjësi të kufizuar, **“Gildberd” shpk.**

Neni 1. Emri, Forma

Shoqëria do të ketë emrin**“Gildberd” shpk**, dhe formë ligjore: “Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar” e quajtur më poshtë “Shoqëria”.

Neni 2 Personaliteti juridik


Shoqëria fiton personalitetin juridik, pasi të jetë regjistruar në QKB, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Neni 3 Selia

Shoqëria **“Gildberd” shpk** e ka seline në adresë:Ruga e Durresit,Zona Kadastrale Nr 8380,Nr Pasurie 2/16-N9,vol 20 fq.26,Tirane dhe mund ta ndryshojë atë me vendim të asamblesë së ortakëve.

Neni 4 Objekti i veprimtarisë

Objekti i ushtrimit të veprimtarise per shoqërine **“Gildberd” shpk** është: Shitje bizhuteri dhe produkte te tjera industriale.



**Neni 5
Kohëzgjatja**

Shoqëria do të zhvilloje aktivitetin e saj pa afat.

**Neni 6
Kapitali themeltar**

Kapitali themeltar i nënshkruar dhe i shlyer i shoqërise është 100,000 lekë, i ndarë në 2(dy) kuota te cilat zotërohet si më poshtë:

Dijana Dulaj, i datëlindjes 18.01.1979, lindur ne Zllakuqan.Kosove dhe banues në Tiranë,identifikuar me dokument identifikimi,kartë identiteti te shtetit te Kosoves, me numër personal ID 1527185, dhe me dokument Leje Qendrimi te republikes se Shqiperise me numer identiteti H98118006M,zoteron 1(nje) kuote ose 50% te kalitalit te shoqerise.

Gjovalin Mali i datëlindjes 19.07.1967, lindur Theth,Shkoder dhe banues ne Tirane,identifikuar me dokument identifikimi,kartë identiteti me numer personal G70719089W, zoteron 1(nje) kuote ose 50% te kalitalit te shoqerise

Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë ,pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta. Ortakët nuk përgjigjen për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara.

**Neni 7
Transferimi i kapitalit**


Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjeter të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit te saj ne Qendren Kombetare të Biznesit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.



Neni 8 Organi Vendimmarrës

Asambleja e Ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë, për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përvèç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

Neni 9 Administrimi

Administrator i shoqërisë “**Gildberd**” **shpk** është: Dijana Dulaj, i datëlindjes 18.01.1979, lindur ne Zllakuqan.Kosove dhe banues në Tiranë,identifikuar me dokument identifikimi,kartë identiteti te shtetit te Kosoves, me numër personal ID 1527185, dhe me dokument Leje Qendrimi te republikes se Shqiperise me numer identitetiH98118006M.


Administratori i shoqërisë është i emëruar për një afat 5(pesë) vjeçar.Data e emërimit te tij përkon me datën e themelimit te shoqerisë qe eshte data 12.09.2024.

Afati i emërimit te administratorit eshte deri me 12.09.2029.

Neni 10 Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë akt themelimi dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet ne kete akt themelimi, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjetër specifik në Republiken e Shqipërisë.



Neni 11
Dispozita perfundimtare

Ky akt themelimi u redaktua ne 3 kopje, në gjuhën shqipe, me përbajtje dhe vlera te njëjta juridike.


Akti i mësiperm pasi miratohet në parim dhe nen per nen nga ortaku themelues të shoqërisë tregtare “**Gildberd** shpk”, nënshkruhet në të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmen orgjinale.

ORTAKET THEMELUES

Dijana Dulaj



Gjovalin Mali



Tiranë, më datë 12.09.2024